



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t’u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 23 tetor Trupi Gjykses urdhëroi shkurtimin e afatit për dorëzimin e kërkesave për pranimin si prova të të gjitha materialeve që nuk kanë të bëjnë me dëshmi të dëshmitarëve. Afati i mëparshëm ishte caktuar për një javë pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari i fundit në këtë çështje.

Trupi Gjykses vuri në dukje se disa nga ditët për seanca gjyqësore nuk u shfrytëzuan, sepse disa dëshmitarë të Mbrojtjes nuk ishin të disponueshëm. Ai vërejti gjithashtu se Mbrojtjes së Thaçit i ishte miratuar kohë shtesë, për t’ju përshtatur këtyre dëshmitarëve. Trupi Gjykses theksoi se është e rëndësishme që koha shtesë të shfrytëzohet, duke rikujtuar njëkohësisht se kjo nuk duhet të cenojë të drejtat e të akuzuarve të tjerë ose interesat e viktimave, duke shkaktuar vonesa të papërligjura në gjykim.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ndryshoi afatin për dorëzimin e kërkesave për pranimin e provave që nuk kanë të bëjnë me dëshmi të dëshmitarëve, të njohura si “mocione për prova jogojore”, deri në jo më vonë se 3 nëntor. Ai urdhëroi më tej që përgjigjet ndaj këtyre mocioneve të dorëzohen më 10 nëntor. Trupi Gjykses theksoi se, në qoftë se Mbrojtja tregon arsye bindëse për parashtrim të mocioneve shtesë për prova jogojore pas 3 nëntorit 2025, ai do t’i shqyrtojë ato kërkesa me kujdesin e duhur për të shmangur dëmin ndaj Mbrojtjes.

Trupi Gjykses udhëzoi Mbrojtjen e Thaçit që të shqyrtojë të gjitha mundësitë në dispozicion për të siguruar që dëshmitarët e propozuar të jenë të disponueshëm në ditët e seancave gjyqësore dhe të sjellë dëshmitarë të tjerë më herët në qoftë se është nevoja. Në rastet kur vështirësia për të udhëtuar mund të shkaktojë vonesa, Trupi Gjykses sugjeroi që të merret parasysh mundësia e dhënies së dëshmisë nëpërmjet videolidhjes. Mbrojtja e Thaçit u urdhërua të japë informacion të përditësuar në lidhje me këto përpjekje deri të mërkurën, 29 tetor.

Më 28 tetor, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për të shtuar disa dokumente që lidhen me deklaratat e dy dëshmitarëve në listën e vet të provave materiale. Trupi Gjykses konstatoi se këto dokumente kishin të bënin me akuzat dhe konstatoi se vlera provuese e tyre nuk zhbëhej nga efekti dëmtues i mundshëm, duke pasur parasysh se palët do të kenë mundësinë të





marrin në pyetje dëshmitarët përkatës në lidhje me këto prova. Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë listën e ndryshuar të provave deri më 31 tetor dhe udhëzoi Administratoren të riklasifikojë kërkesën si publike një javë pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari i fundit.

Më 23 tetor, Trupi Gjykues hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për ndryshim të protokollit që rregullon kontaktet me dëshmitarët. Mbrojtja kishte argumentuar se, meqë Prokuroria ka përfunduar paraqitjen e provave, ajo do të kishte ngarkesë shproporcionale në krahasim me Prokurorinë dhe të bashkakuzuarit e z. Thaçi në çështjen gjyqësore për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve, në qoftë se ajo duhet të vazhdojë t'i përmbahet protokollit në kontaktimin e dëshmitarëve që japin dëshmi në të dyja çështjet.

Trupi Gjykues rikujtoi konstatimet e tij të mëparshme se ky proces është zhvilluar në një atmosferë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe frikësimit të tyre, dhe rreziku i ndërhyrjes, ose i tërheqjes së dëshmive nga dëshmitarët, nuk mund të eliminohet plotësisht, edhe pasi ata të kenë dhënë dëshmi. Trupi Gjykues thekson më tej se kundër z. Thaçi janë ngritur akuza për vepra penale lidhur me ndërhyrje ndaj dëshmitarëve. Duke pasur parasysh se gjykimi ende vazhdon, Trupi Gjykues vendosi se garancitë dhe mbrojtjet e përcaktuara në Protokollin për Kontaktet, vazhdojnë të jenë të domosdoshme dhe të vlefshme për këtë çështje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 28 tetor, Paneli i Apelit vendosi mbi apelet e z. Thaçi kundër vendimeve të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi mocionet paraprake të Mbrojtjes së Thaçit për juridiksionin dhe shtyrjen dhe veçimin e procesit.

Për informacion: në maj të këtij viti, z. Thaçi dorëzoi dy mocione paraprake. Në të parin, ai kërkoi shtyrjen e gjykimit deri në përfundimin e procesit në çështjen për krime lufte, sepse kryerja e dy gjykimeve të njëkohshme kundër tij do të rezultonte në konstatime përkuese dhe do të shkelte të drejtën e Mbrojtjes për gjykim të drejtë. Duke argumentuar se vonesa do të pengonte të drejtën për gjykim të shpejtë të të bashkakuzuarve të tij, ai kërkoi që çështja e tij të veçohet nga ajo e të bashkakuzuarve. Në mocionin e dytë, ai kundërshtoi juridiksionin e Gjykatës së Procedurës Paraprake, duke parashtruar se të gjitha aspektet që lidhen me çështjen gjyqësore për krime lufte duhet të trajtohen nga Trupi Gjykues që gjykon atë çështje. Ai kundërshtoi gjithashtu ligjshmërinë e praktikës që i njëjti person të shërbejë si Gjykatës i Vetëm dhe Gjykatës i Procedurës Paraprake në këtë çështje gjyqësore.





Gjykatësja e Procedurës Paraprake i hodhi poshtë të dy mocionet paraprake, duke theksuar se këto dy çështje janë qartazi të veçuara, sepse kanë të bëjnë me persona të akuzuar të ndryshëm, vepra penale të pretenduara të ndryshme, dhe kuadër kohor të ndryshëm.

Në lidhje me rolin e saj të dyfishtë si Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake, ajo shpjegoi se caktimi i gjykatësve është kompetencë vetëm e Kryetares. Në qoftë se Mbrojtja e Thaçit besonte se kishte arsye për heqjen e saj, duhet të kishte ndjekur procedurën e përcaktuar në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, duke e ngritur këtë aspekt drejtpërdrejt para Kryetares brenda afatit të caktuar.

Në vendimin e tij të fundit, Paneli i Apelit konfirmoi plotësisht arsyetimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në të dy vendimet, duke konstatuar se Mbrojtja e Thaçit nuk kishte arritur të vërtetonte ndonjë gabim në konstatimet e saj.

